



2024

BULETINI

MAJ



Kuvendi i Komunës së Lipjanit zhvilloi punimet e mbledhjes së 30-të

Kuvendi i Komunës së Lipjanit udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 30-të me radhë, në të cilën u aprovuan pikat e rendit të ditës të cilat ishin të propozuara për këtë mbledhje.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmet, fillimisht ka dhënë sqarime në të gjitha çështjet dhe pyetjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Pastaj punimet e seancës kanë vazhduar dhe janë aprovuar këto pika të rendit të ditës



Në tri vitet e ardhshme pritet të ndërtohet ura mbi Lumin Sitnica

Në vlerë prej 70 mijë euro për vitin 2024 dhe mjetet tjera për vitet në vijim gjithësejtë 370 mijë euro nga MMPHI në bashkëfinancim me Komunën e Lipjanit e cila do të mbuloj vlerën tjetër mbi shumën e financimit nga ministria, është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit nga Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti dhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu për bashkëfinancimin e projektit ndërtimin e urës mbi Lumin Sitnica.

Kryetari Imri Ahmeti, ka falënderuar ministrin Aliu për mbështetjen në drejtim të realizimit të këtij projekti, duke thënë se ky projekt i rëndësishëm dhe mëse i nevojshëm do të lehtësoj qarkullimin për qytetarët e asaj pjese të regjionit.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti ka shprehur shqetësimin e tij për kohëzgjatjen e realizimit të këtij projekti për tri vitet e ardhshme duke e ditur edhe rëndësinë e tij dhe se ndarja e vetëm 70 mije euro për vitin 2024 e zvarrite këtë projekt tepër të nevojshëm.



KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 26-të me radhë

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi Daut Azemi ka mbajtur mbledhjen e 26-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Pas prezantimeve dhe diskutimeve për secilën pikë, anëtarët e KPF-së aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës e cila do të mbahet të mërkurën më 08 maj 2024.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti po qëndron në vizitë zyrtare në Izmir të Turqisë

Në një vizitë zyrtare në qytetin e Izmirit të Turqisë, kryetari z. Imri Ahmeti së bashku me nënkryetarin z. Diamant Bytyqin si dhe drejtoreshën e kulturës, rinisë dhe sportit znj. Anila Reçica Llugin vizituan Komunën e Bucas, me të cilën Komuna e Lipjanit është binjakëzuar.

Kryetari Ahmeti gjatë kësaj vizite është takuar me kryetarin e Komunës së Bucas z. Görkem Duman, i cili e ka mirëpritur vizitën e kryetarit Ahmeti dhe njëherish e ka njoftuar rreth qytetit të Bucas.

Më pas vizitën zyrtare e vazhdoi në shoqatën e shqiptarëve "Kosova Rumeli", ku u takua me shumë shqiptarë të cilët punojnë çdo ditë dhe janë të përkushtuar për ruajtjen e gjuhës dhe traditës shqipe dhe së bashku me pjesëmarrësit e shoqatës vizituan parkun e emëruar "Pavarësia e Kosovës".

Gjatë vizitës në qytetin e Izmirit, kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti ka vazhduar vizitën në Komunën e Turgutlusë, ku është pritur nga kryetari z. Çetin Akin, i cili e ka falënderuar kryetarin Ahmeti për vizitën dhe e njoftoi për zhvillimin e qytetit të Turgutlusë.

Vizitën zyrtare e kanë përmbyllur në Shoqatën Kulturore Shqiptare në Turgutlu, ku së bashku me përfaqësuesit e shoqatës vizituan parkun që mban emrin e komandantit legjendar "Adem Jashari".



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka vazhduar vizitën në Komunën e Foçës, ku është pritur nga kryetarja e Komunës, znj. Saniye Bora Fiçi.

Kryetarja e sapozgjedhur, znj. Saniye Bora Fiçi ka shprehur kënaqësi për vizitën e kryetarit Ahmeti dhe e ka njoftuar rreth komunës së Foçës dhe aktivitetet që ata zhvillojnë.

Ndërsa kryetari Ahmeti shprehu gatishmërinë për të ndërtuar ura bashkëpunimi në mes të dy komunave.

“Ne jemi të interesuar të intensifikojmë edhe më shumë bashkëpunimin ndërinstitucional, si dhe të ofrojmë mundësinë e shkëmbimit të bizneseve dhe aktiviteteve kulturore me qëllim të zhvillimit të vendeve tona”, ka thënë kryetari, z. Imri Ahmeti.

Komuna e Foçës është e njohur me një shumicë të disa fshatrave të komunitetit shqiptar, të cilët edhe pas 110 vitesh mërgim vazhdojnë të ruajnë gjuhën dhe traditën shqipe.



Nderohen martirët e fshatit Mirenë

Nënkryetari i Komunës z. Diamant Bytyqi i shoqëruar me bashkëpuntorët, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule duke i nderuar e kujtuar martirët e fshatit Mirenë.

Nënkryetari Bytyqi tha se nderimi dhe respekti për martirët dhe dëshmorët tanë bëhet duke punuar fort për ta ndërtuar shtetin tonë e vendin tonë në një vend të dashur e të zhvilluar për të gjithë.

Lavdi gjithë martirëve dhe dëshmorëve!



Kryetari Ahmeti krenar për triumfin e KFF “Ulpiana 1992” në Ligën e Parë të futbollit të femrave të Kosovës

"Jam shumë i lumtur për suksesin e juaj dhe që me agazhimin tuaj këtë trofe e sollët në Lipjan. Ne jemi krenarë për arritjet e klubeve sportive të komunës sonë andaj gjithmonë do t'i mbështesim ekipet të cilat arrijnë suksese dhe sjellin rezultate të mira. Klubi i Futbollit të Femrave “Ulpiana 1992” edhe pse ka vetëm një vit që është themeluar, ka arritur të na bëjë krenar me futbollistët që ka dhe suksesin e arritur”, tha kryetari Ahmeti.



Drejtoria për Shendetësi dhe Përkujdesje Sociale, ka organizuar një sesion diskutimi me grupin punues për Hartimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

“Ne jemi te interesuar te punojme ngushtë me komunitetin lokal dhe organizatat jo-qeveritare për të siguruar që çdo veprim të ndërmerret në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Ai gjithashtu vlerësoi angazhimin e Kryetarit Imri Ahmeti në përfshirjen dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës publike, duke filluar nga infrastruktura deri te shërbimet institucionale”, ka thënë ndër të tjera nënkryetari Bytyqi.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me nënkryetarin e Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqin si dhe drejtorin e Infrastrukturës z. Sead Aliun kanë vizituar punimet në vazhdim të kompletimit të infrastrukturës sportive.

Në Kraisht ka përfunduar ndërtimi i fushës së hapur të futbollit, ndërsa në Ribar të Madh punimet do të vazhdojnë (pas përfundimit të turnirit).

Njëkohësisht po punohet edhe për renovimin eficient të shkollës fillore në Rufc të Ri, si dhe për ndërtimin e fushës së futbollit në Rufc të Vjetër.



Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN Kosova) organizoi një tryezë me përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit, asamblistë e shoqëri civile për të diskutuar lidhur me kontrollin e brendshëm si dhe trajtimin e veprimeve të ndërmarra për adresim të gjetjeve të ZKA-së.

Në Kraisht ka përfunduar ndërtimi i fushës së hapur të futbollit, ndërsa në Ribar të Madh punimet do të vazhdojnë (pas përfundimit të turnirit).

Njëkohësisht po punohet edhe për renovimin eficient të shkollës fillore në Rufc të Ri, si dhe për ndërtimin e fushës së futbollit në Rufc të Vjetër.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me bashkëpunëtorë kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule pranë pllakës përkujtimore Katër Dëshmorët në fshatit Krojmir, e cila gjendet afër shkollës fillore që mbanë emrin “Katër Dëshmorët”.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se në çdo përvjetor duhet të kujtojmë se liria e Kosovës nuk është fituar lehtë. Prandaj duhet të punojmë fort për të forcuar dhe ndërtuar këtë vend, sepse vetëm në këtë mënyrë ne do t'i respektojmë heronjtë tanë që sakrifikuan jetën e tyre për lirinë që ne e gëzojmë sot.

Po ashtu me aktivitete të ndryshme është shënuar edhe dita e shkollës “Katër Dëshmorët”, në Krojmir.



U mbajt takimi i radhës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB, kryesuar nga Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, sot ka mbajtur takimin e dytë të rregullt për këtë vit, ku u diskutua për gjendjen e sigurisë në komunën tonë.

Në këtë takim, Nënkryetari Bytyqi fillimisht i ka njoftuar të pranishmit rreth përfundimit të procesit të regjistrimit të popullsisë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa sa i përket gjendjes së sigurisë në komunën tonë, ajo vazhdon të jetë e qetë dhe ka ftuar të gjithë të angazhohen në vazhdimësi që kjo situatë stabile e sigurisë të vazhdojë edhe më tutje.



Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 26-të me radhë

Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 26-të e Komitetit për Komunitete (KK) udhëhequr nga kryesuesi i komitetit Skender Bikliqi.

Në këtë mbledhje, përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale kanë paraqitur një informatë lidhur me numrin e rasteve sociale nga komuniteti jo shumicë.

Gjatë kësaj mbledhje u prezantua raporti mujor i punës së ZKKK-së si dhe janë diskutuar edhe shumë çështje të tjera lidhur me kërkesat e qytetareve të Komunës së Lipjanit.



Ka filluar rrënimi i objekteve të vjetra në qendër të Magurës, të cilat janë në pronësi të Agjencisë për Privatizim, por që Komuna e Lipjanit ka marrë përsipër pastrimin e kësaj hapësire, përkatësisht rrënimin e objekteve të vjetra dhe ndërtimin e hapësirave gjelbëruese.

Në të njëjtën kohë, pikërisht në këto hapësira, komuna ka aplikuar për projektet e banimit të përballueshëm.



Nderohet Dëshmori Xhavit Kozhani, martirët e fshatit Ribar i Madh dhe Zllakuqan

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, gjatë ditës së sotme kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule pranë lapidarit të Dëshmorit të Kombit "Xhavit Kozhani" - BURGIA në Lipjan dhe në fshatin Ribar i Madh, në nderim të përvjetorit të rënies së tij.

Delegacioni nga Komuna e Lipjanit kanë bërë homazhe edhe në varrezat e martirëve të këtij fshati, si dhe në fshatin Zllakuqan.



Kryetari Imri Ahmeti pret në takim përfaqësuesit e KFF “Ulpiana 1992”

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim përfaqësuesit e klubit të femrave KFF “Ulpiana 1992”, të cilat janë shpallur kampione të Ligës së Parë të futbollit të femrave në Kosovë për vitin 2023/2024.

Kryetari Ahmeti i ka përgëzuar përfaqësuesit e klubit KFF “Ulpiana 1992” për rezultatin e arritur dhe ka uruar suksese të mëtutjeshme.

“Ndihe mi krenarë për sukseset e klubeve lipjanase, andaj ne gjithmonë do t’i mbështesim ekipet që arrijnë suksese dhe sjellin rezultate, siç ka arritur KFF “Ulpiana 1992” të shpallet kampion,” ka thënë Kryetari Ahmeti.

KFF “Ulpiana 1992” tashmë garën do ta vazhdojë në Sigal Superligën e femrave në futbollit.



Përrurohet çerdhja e re në fshatin Rufc i Ri

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti i shoqëruar me bashkëpunëtorët e tij ka përruar çerdhen e re në fshatin Rufc i Ri, e cila është në dispozicion për 80 fëmijë të kësaj zone.

Kryetari Ahmeti ka uruar banorët e Rufcit të Ri dhe tha se është kënaqësi e veçantë që po hapim një çerdhe modern dhe me ambiente të mira e cila do të jetë në shërbim të fëmijëve tanë.

“Hapja e çerdheve determinon rrugën tonë të së ardhmes dhe është një kënaqësi e veçantë kur krijohen mundësi dhe kushte për prindërit e këtij rajoni për edukimin e fëmijëve qysh në moshën fillestare. Vështirësitë tona natyrisht që nuk janë të vogla, por jam i lumtur që edhe në Rufc të Ri arritëm të ndërtojmë çerdhen e cila do t’u shërbejë fëmijëve tanë”, është shprehur kryetari Ahmeti.

Ai ka theksuar se ndërtimi i kësaj çerdhe ishte premtim që edhe nëpër fshatrat e komunës sonë të ndërtohen hapësira të tilla, në mënyrë që të gjithë atyre prindërve që punojnë të t’iu krijohen mundësi shtesë lehtësimi për vendosjen e fëmijëve të tyre në institucione publike.



Kryetari Ahmeti uron 45 haxhinjtë lipjanas për rrugëtimin drejt Haxhit

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka marrë pjesë në organizimin e Bashkësisë Islame në Lipjan, "Duaja e Haxhinjëve," ceremoni kjo e mbajtur në Shtëpinë e Kulturës "Tahir Sinani" në Lipjan, me rastin e shkuarjes së 45 haxhinjëve në vendet e shenja.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti tha se ndjehet i nderuar që është i pranishëm në këtë ceremoni të lutjeve, por edhe për t'ju uruar të gjithë qytetarëve të Lipjanit udhëtim të mbarë dhe të begatshëm për në Haxh.

"Uroj rrugë të mbarë e shëndet të gjithë atyre që kanë marrë rrugën drejt vendeve të shenja, ndërsa haxhinjëve u uroj pranimin e Haxhit nga i Madhi Zot," ka thënë Ahmeti.



KDI: Komuna e Lipjanit e para për transparencë komunale

Komuna e Lipjanit është renditur e para në nivel vendi në raportin e publikuar sot nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), për vlerësimin e bërë sipas Transparometrit Komunal, për nivelin e transparencës së 38 komunave të Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Komuna e Lipjanit vendin e parë e ndan me komunat e Drenasit, Ferizajt dhe Prizrenit, me një poentim të barabartë, me 94 pikë (97.92%).

Kryetari Imri Ahmeti ka pranuar mirënjohje nga KDI për arritjen si komuna më transparente dhe është shprehur i kënaqur që Komuna e Lipjanit është konfirmuar si më transparentja në nivel vendi.

“Falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe qytetarët lipjanas, që zotimin tonë për transparencë e llogaridhënie, një parakusht i qeverisjes së mirë, po e realizojmë edhe në praktikë. Jam i kënaqur që Komuna e Lipjanit në vazhdimësi ka shënuar progres në rritjen e transparencës falë angazhimit të zyrtarëve komunalë, andaj jam mirënjohës për kontributin e secilit që sot Komunën e Lipjanit e bënë komunë kampione në transparencë,” tha kryetari Ahmeti.

Transparometri Komunal vlerëson 48 indikatorë specifikë që masin elemente të rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe përmbushjen e obligimeve ligjore që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien në raport me qytetarët e tyre.

Në këtë publikim janë pasqyruar të gjeturat e nivelit të transparencës së institucioneve lokale për 38 komunat e Kosovës për vitin 2023.




Autori i librit "Hallaqi i Vogël me Zemër të Madhe", Sefer Tasholli, ka dhuruar 150 libra Komunës së Lipjanit. 100 janë ndarë për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - bibliotekës së qytetit, dhe 50 të tjera për Drejtorinë e Arsimit për shpërndarje nëpër shkolla.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka thënë se ky libër me një domethënie të veçantë për Lipjanin, më vonë do të ketë edhe vlerën e vet në interesim të gjeneratave të reja lidhur me periudhën e okupimit, luftën 98-99, dhunën, vrasjet, djegiet, dëbimet dhe masakrat e okupatorit serb në këtë vendbanim.

Autori Sefer Tasholli ka botuar edhe këto libra: "Kronikë Dritëhijesh", "Monografia Lipjani me Rrethinë", "Plojë e Madhe" për masakrën në Sllovi, dhe së fundmi "Hallaqi i Vogël me Zemër të Madhe".

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë